

Nr. 24 prot

Dt. 31/05/2022



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KËSHILLI I BASENIT UJOR DRIN-BUNË



VENDIM

Nr. 19 , datë 20.05.2022

PËR

**MIRATIMIN E RINOVIMIT TË LEJES “PËR RINOVIMIN E
KUSHTEVE TË LEJES/AUTORIZIMIT”, SHOQËRISË “ARSENI”
SH.P.K.**

Në mbështetje të pikës 2, nenit 50, të ligjit nr.111/2012, “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore”, të ndryshuar, vendimit nr.550, datë 15.7.2020, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e formularëve të kërkesës për miratimin, në parim, për dhënien me koncesion të përdorimit të burimit ujor, e lejes/autorizimit për përdorim burimi ujor, veprimtari ndërtimore në brigje, veprimtari në shtratin e burimit ujor, shkarkime të lëngshme, përdorimin dhe ripërdorimin e ujërave të përdorura, të ndotura, të dokumenteve shoqëruese, të procedurës së shqyrtimit e të vendimmarrjes dhe të afateve të vlefshmërisë së tyre”, me propozimin e Agjencisë së Menaxhimit të Burimeve Ujore, Këshilli i Basenit Drin-Buna.

V E N D O S I:

1. Miratimin e rinovimit të lejes për përdorim burimi ujor nëntokësor nëpërmjet shpimit për linjën e ambllazhimit të ujit në shishe ose në enë të pijeve joalkolike, subjektit “ARSENI” sh.p.k., me vendndodhje Bashkia Shkodër, Qarku Shkodër sipas këtyre koordinatave:

2. Treguesit paraprak janë si më poshtë:

Vendndodhja e burimit ujq KRGJSH

- X=458450
- Y=4664340
- Z=15 m

Sasia e ujit që do të përdoret $Q=2$ l/sek

Vendndodhja e shkarkimit KRGJSH

- X=4584436
- Y=4664307
- Z=14 m

3. Ngarkohet Agjencia e Menaxhimit të Burimeve Ujqore për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYETARI I KBU DRIN-BUNË

MAJLINDA ANGONI

